



Në bazë të nenit 10, paragrafi (1) të Ligjit për subvencionim të kredisë banesore (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 158/11, 24/13, 43/14, 109/14 dhe 6/16 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 101/19) dhe nenit 2 të Vendimit për kohëzgjatjen dhe numrin e thirrjeve publike për aplikimin e qytetarëve për marrjen e kredisë së subvencionuar banesore në vitin 2022 (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 118/2022), Ministria e Financave publikon

THIRRJE PUBLIKE
për aplikimin e qytetarëve për marrjen e kredisë së subvencionuar banesore
në periudhë prej datës 1 qershor deri në 31 gusht viti 2022

1. Thirren të gjithë qytetarët e interesuar për marrjen e kredisë së subvencionuar banesore, të parashtrojnë aplikimet e tyre në periudhën prej datës **1 qershor të vitit 2022 deri në 31 gusht të vitit 2022**.
2. Të gjithë qytetarët që janë të interesuar për marrjen e kredisë së subvencionuar banesore mund të aplikojnë për:

I - Blerje të banesës së re:

➤ **Subvencion i një pjesë të këstit mujor**

Qeveria do paguajë 50% të anuitetit mujor (kryegje dhe interes) në 5 vitet e para të pagesës së kredisë për personat mbi moshën 35 vjeç, përkatësisht 70% të anuitetit mujor (kryegje dhe interes) në 5 vitet e para të pagesës së kredisë për të rinjtë deri në moshën 35 vjeçare.

Norma e interesit është:

- 2.9% për tre vitet e para,
- 3.9% për vitin e katërt dhe të pestë.

➤ **Subvencion i një pjese të pjesëmarrjes**

Qeveria do paguajë 50% të pjesëmarrjes së nevojshme për marrjen e kredisë, më së shumti deri në 6.250 euro për personat mbi moshën 35 vjeç. Qeveria do paguajë 70% të pjesëmarrjes së nevojshme për marrjen e kredisë më së shumti deri në 8.750 euro për të rinjtë deri në moshën 35 vjeçare.

Norma e interesit është:

- EURIBOR 6 mujor + 4 pikë përqindje për tërë kohëzgjatjen e pagesës së kredisë.

Subvencioni është i pakthyeshem në rast të pagesës së rregullt të kredisë banesore, si dhe në rast të pagesës vullnetare të parakohshme të kredisë banesore pas përfundimit të vitit të 10-të të pagesës së kredisë për këto modele.

Pas përfundimit të vitit të 5-të të pagesës së kredisë për këto modele, shfrytëzuesi i kredisë së subvencionuar banesore ka të drejtë të kryejë një herë pagesë të pjesërishme me mjetet e veta, por jo më shumë se 20% të kryegjesë së mbetur të kredisë.

II. Ndërtim/blerje e shtëpisë së re:

➤ **Subvencion i një pjese të këstit mujor**

Qeveria do paguajë 80% të anuitetit mujor (kryegje dhe interes) në 5 vitet e para të pagesës së kredisë për personat mbi moshën 35 vjeç. Qeveria do paguajë 60% të anuitetit mujor (kryegje dhe interes) në 3 vitet e para të pagesës së kredisë, 50% të anuiteti mujor në 5 vitet e ardhshme dhe 40% të anuitetit mujor në 3 vitet e ardhshme të pagesës së kredisë për të rinjtë deri në moshën 35 vjeçare.

Norma e interesit është:

- 2.9% për tre vitet e para,
- 3.9% për vitin e katërt dhe të pestë.

➤ **Subvencion i një pjese / tërë pjesëmarrjes**

Qeveria do paguajë 80% të pjesëmarrjes së nevojshme për marrjen e kredisë, përkatësisht më së shumti deri më 10.000 euro me kundërvlerë në denarë për personat mbi moshën 35 vjeç. Qeveria do paguajë vlerën e tërësishme të pjesëmarrjes së nevojshme për marrjen e kredisë, përkatësisht më së shumti deri në 12.500 euro me kundërvlerë në denarë për të rinjtë deri në moshën 35 vjeçare.

Norma e interesit është:

- EURIBOR 6 mujor + 4 pikë përqindje për tërë kohëzgjatjen e pagesës së kredisë.

Subvencioni është i pakthyeshem në rast të pagesës së rregullt të kredisë banesore. Subvenconi është i pakthyeshem në rast të pagesës vullnetare të parakohshme të kredisë banesore pas përfundimit të vitit të 10-të të pagesës së kredisë për modelin e subvencionit të një pjese të këstit mujor për personat mbi moshën 35 vjeç dhe për modelin e subvencionit prej 80% të pjesëmarrjes. Subvencioni është i pakthyeshem në rast të pagesës vullnetare të parakohshme të kredisë banesore pas përfundimit të vitit të 12-të të pagesës së kredisë për modelin e subvencionit të një pjese të këstit mujor për të rinjtë deri në moshën 35 vjeçare dhe për modelin e subvencionit prej 100% të pjesëmarrjes.

Pas përfundimit të vitit të 5-të të pagesës së kredisë për modelin e subvencionit të një pjese të këstit mujor për personat mbi moshën 35 vjeç dhe për modelin e subvencionit prej 80% të pjesëmarrjes, përkatësisht pas përfundimit të vitit të 11-të të pagesës së kredisë për modelin e subvencionit të një pjese të këstit mujor për të rinjtë deri në moshën 35 vjeçare dhe për modelin e subvencionit prej 100% të pjesëmarrjes, shfrytëzuesi i kredisë së subvencionuar banesore ka të drejtë të kryejë një herë pagesë të pjesërishme me mjetet e veta, por jo më shumë se 20% të kryegjesë së mbetur të kredisë.

III. Mbindërtim/zgjerim i shtëpisë:

➤ **Subvencion i një pjesë të këstit mujor**

Qeveria do paguajë 75% të anuitetit mujor (kryegje dhe interes) në 5 vitet e para të pagesës së kredisë për personat mbi moshën 35 vjeç. Qeveria do paguajë 50% të anuitetit mujor (kryegje dhe interes) në 3 vitet e para të pagesës së kredisë, 40% të anuiteti mujor në 5 vitet e ardhshme dhe 30% të anuitetit mujor në 3 vitet e ardhshme të pagesës së kredisë për të rinjtë deri në moshën 35 vjeçare.

Norma e interesit është:

- 2.9% për tre vitet e para,
- 3.9% për vitin e katërt dhe të pestë.

➤ **Subvencion i një pjese / tërë pjesëmarrjes**

Qeveria do paguajë 75% të pjesëmarrjes së nevojshme për marrjen e kredisë, përkatësisht më së shumti deri në 9.375 euro me kundërvlerë në denarë për personat mbi moshën 35 vjeç. Qeveria do

paguajë vlerën e tërësishme të pjesëmarrjes së nevojshme për marrjen e kredisë, përkatësisht më së shumti deri në 12.500 euro me kundërvlerë në denarë për të rinjtë deri në moshën 35 vjeçare.

Norma e interesit është:

- EURIBOR 6 mujor + 4 pikë përqindje për të tërë kohëzgjatjen e pagesës së kredisë.

Subvencioni është i pakthyeshëm në rast të pagesës së rregullt të kredisë banesore. Subvencioni është i pakthyeshëm në rast të pagesës vullnetare të parakohshme të kredisë banesore pas përfundimit të vitit të 10-të të pagesës së kredisë për modelin e subvencionit të një pjese të këstit mujor për personat mbi 35 vjeç dhe për modelin e subvencionit prej 75% të pjesëmarrjes. Subvencioni është i pakthyeshëm në rast të pagesës vullnetare të parakohshme të kredisë banesore pas përfundimit të vitit të 12-të të pagesës së kredisë për modelin e subvencionit të një pjese të këstit mujor për të rinjtë deri në moshën 35 vjeçare dhe për modelin e subvencionit prej 100% të pjesëmarrjes.

Pas përfundimit të vitit të 5-të të pagesës së kredisë për modelin e subvencionit të një pjese të këstit mujor për personat mbi 35 vjeç dhe për modelin e subvencionit prej 75% të pjesëmarrjes, përkatësisht pas përfundimit të vitit të 11-të të pagesës së kredisë për modelin e subvencionit të një pjese të këstit mujor për të rinjtë deri në moshën 35 vjeçare dhe për modelin e subvencionit prej 100% të pjesëmarrjes, shfrytëzuesi i kredisë së subvencionuar banesore ka të drejtë një herë të paguajë pagesë të pjesërishme me mjetet e veta, por jo më shumë se 20% të kryegjësë së mbetur të kredisë.

3. Nëse në periudhë prej dhjetë vjetëve nga marrja e subvencionit, familja e shfrytëzuesit të kredisë së subvencionuar banesore zgjerohet me lindjen e një fëmije në jetë ose me birësimin e një fëmije, ka të drejtë të vazhdojë periudhën e subvencionimit për periudhë prej një viti në lartësi prej 30 % të anuitetit mujor për secilin fëmijë.

4. Subvencionimi i kredisë për të gjitha modelet aprovohet për kredinë banesore vlera e së cilës nuk tejkalon 50.000 euro me kundërvlerë në denarë me kursin e mesëm të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut në ditën e aprovimit të kredisë dhe në afat të pagesës jo më pak se 20 vjet. Nëse kredia banesore është më e madhe se vlera prej 50.000 euro, diferenca që e tejkalon këtë vlerë nuk subvencionohet.

5. Qytetarët të cilët janë shtetas të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe me vendbanim të përhershëm në territorin e vendit, mund të aplikojnë për marrjen e kredisë së subvencionuar banesore nëse i plotësojnë këto kushte:

- Të ardhurat e përgjithshme mujore të personit-individ të jenë deri në 900 euro në muaj;
- Të ardhurat e përgjithshme mujore të çiftit bashkëshortor të jenë deri në 1.300 euro në muaj;
- Çmimi i shitjes së objektit banesor me TVSH-në e llogaritur të jetë deri në 900 euro për metër katror;
- Kredikërkuesi të mos ketë në pronësinë e tij, në bashkëpronësi ose pronësi të përbashkët me çiftin bashkëshortor ose në pronësi të çiftit bashkëshortor banesë, përkatësisht shtëpi, ose të ketë në bashkëpronësi të tij ose në bashkëpronësi të çiftit bashkëshortor, një pjesë të banesës/shtëpisë ose pjesë të disa banesave/shtëpive të fituara në bazë të trashëgimisë ose dhuratave, vlera e përgjithshme e të cilave nuk tejkalon 30.000 euro, me kundërvlerë në denarë të llogaritur me kursin mesatar të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut në ditën e dorëzimit të kërkesës për kredi të subvencionuar banesore;
- Kredikërkuesi të mos ketë në pronësinë e tij, në bashkëpronësi ose pronësi të përbashkët me çiftin bashkëshortor ose në pronësi të çiftit bashkëshortor toka (bujqësore, ndërtimore, pyjore dhe kullota), ndërtesa afariste dhe hapësira afariste, ndërtesa administrative dhe hapësira administrative, shtëpi dhe banesa për pushim dhe rekreacion, vlera e përgjithshme e të cilave është më e madhe se 30.000 euro me kundërvlerë në denarë e llogaritur sipas kursit mesatar të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut në ditën e dorëzimit të kërkesës për kredi të subvencionuar banesore. Në vlerën

e përgjithshme nuk llogaritet vlera e tokës ndërtimore në të cilën aplikuesi do të ndërtojë me mjetet e siguruar nga kredia e subvencionuar banesore;

- Kredikërkuesi i cili ka në pronësinë e tij, në bashkëpronësi ose pronësi të përbashkët me çiftin bashkëshortor ose në pronësi të çiftit bashkëshortor vetëm një banesë ose shtëpi, ta shesë atë me qëllim të blerjes së një banese më të madhe ose për ndërtimin/blerjen e shtëpisë së re më të madhe në periudhë prej tre vjetësh deri në ditën e aplikimit për marrjen e kredisë së subvencionuar banesore ose ta rrënojë atë për ndërtimin e një shtëpie të re më të madhe për nevojat e akomodimit të tyre;
- Kredikërkuesi i cili nuk ka në pronësinë e tij, në bashkëpronësi ose pronësi të përbashkët me çiftin bashkëshortor ose në pronësi të çiftit bashkëshortor banesë, përkatësisht shtëpi, të ketë lidhur marrëveshje për ndërtim me pronarin e shtëpisë për të kryer mbindërtim ose zgjerim për nevojat e akomodimit të tij dhe dokumentacioni tekniko-ndërtimor të jetë në emër të kërkuesit të kredisë;
- Personi ose çifti bashkëshortor i tij, të mos ketë marrë kredi tjetër banesore në ditën e dorëzimit të kërkesës për kredi të subvencionuar të banesore;
- Personi i cili aplikon ka dhënë deklaratë të vërtetuar në noter se nuk do të marrë me qira, tjetërsojë dhe të ngarkojë në mënyrë shtesë me hipotekë banesën/shtëpinë e blerë ose të ndërtuar me mjete të kredisë së subvencionuar banesore në periudhë prej 5 viteve të para nga fillimi i pagesës së kredisë, përkatësisht në periudhë prej 12 viteve të para nga fillimi i pagesës së kredisë në varësi të modelit të subvencionimit;
- Banesa që do të blihet, përkatësisht shtëpia që do të blihet/ndërtohet, të jetë ndërtim i ri me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm teknik të ndërtimit (fletëpronësi, lejet për ndërtim) dhe të ndërtohet në përputhje me Ligjin për ndërtim. Leja e ndërtimit duhet të jetë në emër të kërkuesit të kredisë së subvencionuar banesore;
- Banesa/shtëpia të blihet drejtpërdrejt nga investitori ose realizuesi i ndërtesës banesore;
- Pasuria e paluajtshme që është subjekt i subvencionit të mos blihet/ndërtohet nga personi fizik ose juridik investitor me themeluesit ose pronarët e të cilit, aplikuesi ose çifti i tij bashkëshortor është person i lidhur në përputhje me rregulloret që përcaktojnë punën bankare;
- Të përmbushen kushtet për marrjen e kredisë banesore të përcaktuar nga banka afariste.

6. Subvencionimi i kredisë banesore mund të shfrytëzohet për blerjen e banesës së re, mbindërtimin/zgjerimin e njësisë së veçantë banesore në kuadër të një shtëpisë ekzistuese ose ndërtimin/blerjen e shtëpisë së re, sipërfaqja e së cilës nuk tejkalon 150 m².

7. Personat e interesuar mund të aplikojnë për marrjen e kredisë së subvencionuar banesore në një nga bankat vijuese:

- | | |
|-----------------------------|----------------------------|
| - NLB Banka SHA Shkup | - Silk Road Bank SHA Shkup |
| - Stopanska Banka SHA Shkup | - TTK Bank SHA Shkup |
| - Shparkase Banka SHA Shkup | - ProCredit Bank SHA Shkup |
| - Ohridska Banka SHA Shkup | |

8. Gjatë thirrjes publike në vitin 2022, qytetarët e interesuar do të duhet t'i dorëzojnë personalisht kërkesat së bashku me dokumentacionin e nevojshëm për marrjen e kredisë së subvencionuar banesore në bankën afariste të përzgjedhur edhe atë në periudhën prej datës 1 qershor të vitit 2022, duke përfshirë datën 31 gusht të vitit 2022. Kërkesat me dokumentacion të pakompletuar nuk do të shqyrtohen.

9. Procedura për përzgjedhjen e shfrytëzuesve për kredi të subvencionuar banesore zbatohet përmes sistemit elektronik për përzgjedhjen e shfrytëzuesve të paktën një herë në periudhë prej 35 ditëve, për të gjitha vendimet e marra për para-aprovimin e kredisë së subvencionuar banesore të dorëzuar së paku një ditë para datës së zbatimit të procedurës për përzgjedhje.

10. Për informacione më të hollësishme, drejtohuni në Ministrinë e Financave dhe në faqen e internetit <https://finance.gov.mk/>.

Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut
Ministria e Financave
<https://finance.gov.mk/>